

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të  
Auditimit të Brendshëm  
Internal Audit Knowledge  
Elements**

**B1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

**CONTENT / PËRMBAITJA**

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</b>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
<b>Total</b>	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

1. Një korporatë duhet të menaxhohet sipas cilit nga parimet e mëposhtme?

- A. Qeverisjes korporative.
- B. Kontrollit të korporatës.
- C. Ligjit të korporatës.
- D. Etikës së korporatës.

2. Cilat nga këto janë arsytet për mungesën e pavarësisë së bordit të drejtorëve të një kompanie?

- I. Drejtorët e brendshëm kanë lidhje të ngushta me krye-shefin ekzekutiv (CEO).
  - II. Drejtorët e brendshëm janë anëtarë të familjes dhe miq të CEO.
  - III. CEO kontrollon proceset e anëtarëve të bordit.
  - IV. Numri i drejtorëve të brendshëm është më i madh se numri i drejtorëve të jashtëm.
- A. Vetëm I.
  - B. I dhe II.
  - C. Vetëm IV.
  - D. I, II, III dhe IV.

3. Cila nga kodet e qeverisjes në vijim lidhet posaçërisht me Aktin e ShBA Sarbanes - Oxley të vitit 2002?

- A. Barazia e aksionarëve.
- B. Përgjegjësia e Bordit dhe Menaxhmentit.
- C. Shpalesja e raportimit financiar dhe transparenca.
- D. Pavarësia e auditorit dhe drejtorit.

4. Sa i përket parimeve etike, cila nga të mëposhtmet përcakton siç duhet rregullën e artë?

- A. Ai deklaron se secili duhet të vejë veten në këpucë të të tjerëve. Kjo nënkupton që me vetëdije të mos i bëjmë dëm të tjerëve.
- B. Ai deklaron se kur qëllimet janë me rëndësi thelbësore, mjetet e paskrupullta mund të përdoren për të arritur qëllimet.
- C. Ai deklaron se drejtësia përkufizohet si interesi i më të fortëve, që do të thotë se njerëzit më të fortë janë më lartë se njerëzit më të dobët.
- D. Është e ngjashme me etikën utilitariste dhe me etikën e organizatës.

5. Cila nga sa më poshtë ofron nivelin më të lartë të praktikave të përgjegjësisë shoqërore?

- A. Qëndrimi proaktiv.
- B. Qëndrimi përshtatës.
- C. Qëndrimi mbrojtës.
- D. Qëndrimi parandalues.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

6. Cila nga qasjet e mëposhtme nuk përdoret nga menaxherët e rrezikut për të identifikuar rreziqet?

- A. Analiza e kontratave.
- B. Analiza statistikore.
- C. Inxhinieria financiare.
- D. Inspektimet në vend.

7. Korporata BIK është duke e përcaktuar rrezikun e vet objektiv që rezulton nga incidentet e zjarrit në katër depo të saj. Çdo depo ka të njëjtën sipërfaqe (një milion metra katrorë) dhe secila depo ka gjithsej 100 incidente zjarri të vogla dhe të mëdha në vit. Departamenti i menaxhimit të rrezikut të korporatave vlerësoi numrin aktual të incidenteve të zjarrit si një varg (prej deri) gjatë vitit të ardhshëm me probabilitetet e rezultateve, siç tregohet në tabelën në vijim.

Depo	Incidentet e zjarrit	Probabiliteti i Rezultatit
1	95-105	Më shumë gjasa
2	80-120	Më shumë gjasa
3	70-80	Më shumë gjasa
4	80-85	Më shumë gjasa

Cila nga depot ka shkallën më të lartë të rrezikut objektiv?

- A. Depo 1.
- B. Depo 2.
- C. Depo 3.
- D. Depo 4.

8. Cila nga këto është qëllimi i menaxhimit tradicional të rrezikut të korporatave?

- I. Trajton njërin kah të rrezikut, rrezikun në ulje.
  - II. Trajton të dy kahet e rreziqeve, rreziqet në ulje dhe në rritje.
  - III. Fokusetohet në portofolin e pjesshëm të rreziqeve të tilla si rreziqet financiare dhe hazarde.
  - IV. Fokusetohet në rrezikun e portfolios së përgjithshme, duke përfshirë rreziqet financiare, rreziqet hazarde, rreziqet strategjike dhe ato operacionale.
- A. Vetëm I.
  - B. I dhe III.
  - C. Vetëm II.
  - D. II dhe IV.

9. Cili nga rreziqet në vijim është përcaktuar të jetë një nivel i arsyeshëm i rrezikut?

- A. Rreziku minimal.
- B. Rreziku i pranueshëm.
- C. Rreziku i mbetur.
- D. Rreziku i përgjithshëm.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

10. Nga këndvështrimi i menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes, të gjithë nga të mëposhtmit mund të mbikëqyrin aktivitetet e menaxhimit të rrezikut, përveç:

- A. Udhëheqësi financiar.
- B. Kryeshefi Ekzekutiv.**
- C. Shefi ekzekutiv i auditimit.
- D. Shefi i riskut.

11. Menaxhimi i burimeve të ndërmarrjes shihet si një vlerë e menjëhershme në cilën prej fushave të mëposhtme?

- I. Menaxhimin e kapitalit.
  - II. Konsistencën e fitimeve.
  - III. Planifikimin e pasigurive.
  - IV. Kontrollin e shpenzimeve.
- A. Vetëm I.
  - B. Vetëm II.
  - C. I dhe III.**
  - D. II dhe IV.

12. Qëllimi përfundimtar i menaxhimit të rrezikut është:

- A. Të minimizoj shpenzimet e sigurimeve.
- B. Të minimizoj humbjet e pasiguruara.
- C. Të minimizoj efektet negative të humbjeve dhe pasigurive që lidhen me rreziqet e pastra.**
- D. Të eliminoj humbjet financiare dhe operacionale.

13. Detyrat rutinore, të cilat kanë pak përjashtime dhe probleme që janë të lehta për ti analizuar, janë të favorshme për:

- A. Strukturë të formalizuar, ku manualet për procedura dhe përshkrimet e punës janë të zakonshme.**
- B. Vendimmarrje të decentralizuar, ku vendimet shtyhen në rrjedhjen e poshtme të organizatës.
- C. Strukturë organike e cila thekson përshtat - shmëri dhe fleksibilitet për ndryshimin e rrethanave.
- D. Shkallë të lartë të kënaqësisë në punë nga ana e punonjësve të cilët i kryejnë ato.

14. Në një organizatë dinamike, një menaxher analizon situatat problematike dhe i përgjigjet çdo situatë. Teoria e menaxhimit që përshkruan më së miri këtë qasje është:

- A. Teoria e sistemeve të përgjithshme.
- B. Teoria e sjelljes.
- C. Teoria e operacioneve.
- D. Teoria kontingjente.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

15. Një biznes që është i organizuar në disa njësi gjysmëautonome - secila me financimin, marketingun dhe përpjekjet e prodhimit të veta - është duke përdorur një metodë të organizimit të njohur si:

- A. Departamentizim funksional.
- B. Departamentizim organik.
- C. Departamentizim produkt-shërbim.
- D. Departamentizim i njësive strategjike të biznesit.

16. Cila nga të mëposhtmet vepron si një biznes i pavarur?

- A. Njësia strategjike e biznesit.
- B. Njësia taktike e biznesit.
- C. Njësia operative e biznesit.
- D. Njësia funksionale e biznesit.

17. Një kompani e cila është duke lansuar një produkt të ri duhet të përdorë strategjinë e çmimeve depërtuese, nëse:

- A. Shpenzimet e investimeve janë të ulëta.
- B. Ka pak kërcënim për konkurrencën e kopjimit.
- C. Elasticiteti i çmimit të kërkesës është joelastik.
- D. Më shumë vëllim do të thotë kosto më e ulët e prodhimit.

18. Me një kërkesë elastike, rritja e çmimeve do të:

- A. Ulë të ardhurat marginale.
- B. Ulë të ardhurat totale.
- C. Rris të ardhurat totale.
- D. Ulë të ardhurat marginale dhe të ardhurat totale.

19. Thelbi i konceptit pikërisht - në - kohë është:

- A. Ulja e shpenzimeve për materialet dhe pjesët.
- B. Dorëzimi i pjesëve dhe materialeve pa defekte në procesin e prodhimit, vetëm në momentin kur ato janë të nevojshme.
- C. Rritja e përgjegjshmërisë ndaj nevojave të furnizuesit.
- D. Eliminimi i furnizuesve të panevojshëm.

20. Cila nga të mëposhtmet është qëllimi përfundimtar i zinxhirit të furnizimit?

- A. Zinxhiri i furnizimit është një sistem i transformimit të inputit në output.
- B. Zinxhiri i furnizimit shihet si zëri i mirë i klientit.
- C. Zinxhiri i furnizimit shihet si një zinxhir i vlerës.
- D. Zinxhiri i furnizimit shihet si zëri i mirë i furnizuesit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** Nga 2 pikë secila

21. Cila nga të mëposhtmet duhet adaptuar për të përmbushur mundësitë dhe sfidat e veçanta të secilës fazë të ciklit jetësor të produktit?
- A. Udhëheqësi i projektit duhet të emërohet.
  - B. Struktura e përgjithshme e menaxhimit duhet të jetë në vend.
  - C. Strategjia dhe taktikat e marketingut duhet të jenë në vend.
  - D. Strategjia e prodhimit duhet të jetë në vend.
22. Sa i përket rrjedhave të procesit të prodhimit, cila prej të mëposhtmeve nuk është pjesë e levave për të kontrolluar ndryshueshmërinë e procesit?
- A. Analizimi i ndryshueshmërisë në masat kyçe të performancës.
  - B. Menaxhimi i kapacitetit të sigurisë.
  - C. Vendosja e kufijve të kontrollit në masat kryesore të performancës.
  - D. Monitorimi i performancës aktuale.
23. Organizata që mëson, i vë theksin cilës nga të mëposhtmet?
- A. Komunikimit të kryqëzuar.
  - B. Komunikimit horizontal.
  - C. Komunikimit nga lart-poshtë.
  - D. Komunikimit nga poshtë-lart.
24. Cili nga të mëposhtmit është mekanizmi kryesor i monitorimit në dispozicion të aksionarëve?
- A. Zyrtarët e kompanisë.
  - B. Kompania jo zyrtare.
  - C. Bordi i drejtorëve të kompanisë.
  - D. Punonjësit e kompanisë.
25. Një strategji e nivelit funksional ka të bëjë me cilën nga pyetjet e mëposhtme?
- A. Në çfarë biznesi jemi të përfshirë ne?
  - B. Si mund të garojmë?
  - C. Si e mbështesim strategjinë tonë të zgjedhur?
  - D. Çfarë biznesi kemi blerë?
26. Cila nga këto është një aktivitet biznesi që një organizatë e bën veçanërisht mirë në krahasim me konkurrencën e saj?
- A. Strategjia.
  - B. Sinergjia.
  - C. Lopët e parave.
  - D. Kompetenca kryesore.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

27. Në lidhje me implementimin e strategjisë dhe kontrollin strategjik:

- A. Implementimi i strategjisë është më i rëndësishëm se kontrolli strategjik.
- B. Implementimi i strategjisë i referohet detajeve të realizimit të strategjisë, ndërsa kontrolli strategjik i referohet vlerësimit të vazhdueshëm dhe përshtatjes së strategjisë.
- C. Kontrolli strategjik është më i rëndësishëm se implementimi i strategjisë.
- D. Implementimi i strategjisë i referohet kryesisht përcaktimit të fushës, ndërsa kontrolli strategjik i referohet kryesisht navigimit të fushës.

28. Në kontekstin e menaxhimit total të cilësisë (TQM), korrelacioni midis dy karakteristikave të produktit kryhet me një:

- A. Listat e drejtuara.
- B. Histogramët.
- C. Diagramet shpërndarës (scatter).
- D. Grafikët e kontrollit.

29. Klientët kanë një kohë të vështirë të vlerësimit objektiv të shërbimeve për shkak të të cilës nga të mëposhtmet?

- A. Paprekshmërisë.
- B. Heterogjeniteti.
- C. Prishjes.
- D. Pandashmërisë.

30. Nëse një kompani është me klientin-si qendër, klientët e saj përcaktohen si:

- A. Vetëm njerëzit jashtë kompanisë që kanë blerë diçka nga kompania.
- B. Vetëm njerëzit e brendshëm të kompanisë që përdorin direkt produktin e saj.
- C. Çdokush që është jashtë kompanisë dhe atyre të brendshëm që mbështeten në produktin e saj për të kryer punën e tyre.
- D. Të gjithë personat e jashtëm të kompanisë që aktualisht po bëjnë, ose mund të bëjnë në të ardhmen, biznes me kompaninë.

31. Menaxhmenti dhe punonjësit e një kompanie të madhe të lëvizjes së mallrave shtëpiake kanë vendosur të miratojnë menaxhimin e cilësisë së përgjithshme (TQM) dhe përmirësimin e vazhdueshëm (CI). Ata besojnë se nëse kompania e tyre u bë e njohur në nivel kombëtar si rrjedhojë e aderimit në TQM dhe CI, një rezultat do të ishte rritja e fitimeve të kompanisë dhe pjesës së tregut. Cilësia arrihet më ekonomikisht nëse kompania fokusohet në:

- A. Shpenzimet e vlerësimit.
- B. Shpenzimet e parandalimit.
- C. Shpenzimet e dështimit të brendshme.
- D. Shpenzimet e dështimit të jashtëm.

32. Menaxhmenti identifikues është i zbatueshëm në cilin nga llogaritë vijuese?

- A. Llogaritë e Grupit.
- B. Llogaritë e përdoruesve lokal.
- C. Llogaritë e vizitorëve.
- D. Llogaritë anonime.



Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

33. Cila nga deklaratat e mëposhtme nuk është e saktë për një mbyllje të sesionit në kontrollin e qasjes?
- A. Një mbyllje e sesionit është zëvendësim për dalje nga sistemi.
  - B. Një mbyllje e sesionit mund të aktivizohet në një pajisje me ekran.
  - C. Një mbyllje e sesionit vendos një model publikisht të dukshëm në pamjen e ekranit të pajisjes.
  - D. Një mbyllje e seksioneve fsheh atë që ishte parë më parë në ekranin e pajisjes.
34. Secilit përdorues i jepet hapësira më e ulët e nevojshme për të kryer detyra të autorizuara. Cila nga parimet e mëposhtme është kjo?
- A. Parimi i privilegjit më të vogël.
  - B. Parimi i ndarjes së detyrave.
  - C. Parimi i hapësirës së sistemit.
  - D. Parimi i akreditimit të sistemit.
35. Cila nga mekanizmat e qasjes në vijim krijon një problem të mundshëm të sigurisë?
- A. Mekanizmi i qasjes me bazë vendndodhjen.
  - B. Mekanizmi i qasjes me bazë adresën e Protokollit të Internetit (IP).
  - C. Mekanizëm i qasjes me bazë tokenin.
  - D. Mekanizëm i qasjes me bazë internetin.
36. Cila nga të mëposhtmet është më e mira për të zëvendësuar përdorimin e numrave identifikues personal (PIN) në botën e makinave të automatizuara (ATM)?
- A. Teknologji e identifikimit (zbulimit) të Irisit të syrit.
  - B. Teknologjia e zërit.
  - C. Teknologjia e dorës.
  - D. Teknologjia e gjurmëve të gishtave.
37. Çfarë janë sulmet mashtruese?
- A. Sulme aktive.
  - B. Sulme pasive.
  - C. Sulme mbikëqyrëse.
  - D. Sulme shtruese.
38. Masat mbrojtëse dhe kontrollet e sigurisë nuk mund të bëjnë cilën nga të mëposhtmet?
- A. Reduktimin e rrezikut.
  - B. Shmangien e rrezikut.
  - C. Transferimin e rrezikut.
  - D. Analizën e rrezikut.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

39. Cila nga të mëposhtmet duhet të mbrohet për një performancë të pasuksesshme?

- A. Skanerët e virusit.
- B. Muret mbrojtëse (firewalls).
- C. Filterët bllokues.
- D. Portet e rrjetit.

40. Protokollin e sigurisë së shtresës së transportit (TLS) nuk siguron cilën nga të mëposhtmet?

- A. Integritetin.
- B. Restaurimin e gabimeve.
- C. Autenticitetin (vërtetimin/validimin).
- D. Ngarkesat e koduar.

41. Cila nga të mëposhtmet nuk është e vërtetë në lidhje me nënshkrimin digjital?

- A. Është një fragment i koduar i tekstit që dërgohet së bashku me një mesazh.
- B. Autentifikon identitetin e dërguesit të një mesazhi.
- C. Ai garanton që askush nuk e ka ndryshuar dokumentin e dërguar.
- D. Nënshkrimet elektronike dhe nënshkrimet digjitale janë të njëjta.

42. Cilat janë efektet e një regjistrimi në ditar që përdoren për shitjet me afat pagese?

- A. Pasuritë: Zvogëlim; Detyrimet: Nuk ka efekt; Kapitali i pronarit: Zvogëlim
- B. Pasuritë: Rritje; Detyrimet: Nuk ka efekt; Kapitali i pronarit: Rritje
- C. Pasuritë: Nuk ka efekt; Detyrimet: Zvogëlim; Kapitali i pronarit: Rritje
- D. Pasuritë: Nuk ka efekt; Detyrimet: Rritje; Kapitali i pronarit: Zvogëlim

43. Një kompani me pasuri totale prej 100,000,000€ dhe fitim neto prej 9,000,000€, blen pajisje me një jetë të vlerësuar prej 10 vjet për 1,000€. Blerjen e këtyre pajisjeve, kompania e debiton tek shpenzimet e ndryshme. Ky skenar është më i lidhur me cilin nga konceptet ose parimet e mëposhtme?

- A. Materialiteti dhe parimi i vijimësisë.
- B. Rëndësia dhe neutraliteti.
- C. Besueshmëria dhe krahasueshmëria/konsistenca.
- D. Materialiteti dhe kosto/përfitim.

44. Sipas një plani pensional me kontribute të përcaktuar, shuma që paguhet: (A) raportohet në bilancin e gjendjes si çka? **vetëm nëse** shuma që organizata ka kontribuar në trustin pensional është (B) shuma e kërkuar.

	I.	II.	III.	IV.
A	Një pasuri	Një pasuri	Një detyrim	Një detyrim
B	Më e madhe se kontributi i përcaktuar	E barabartë me kontributin e përcaktuar	Më e madhe se kontributi i përcaktuar	E barabartë me kontributi i përcaktuar

- A. I.
- B. II.
- C. III.
- D. IV.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

45. Më 1 janar 2012, një kompani bleu një pasuri bimore për 300,000€. Duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit për jetëgjatësinë prej 10 vjetësh dhe pa vlerë të mbetur, kompania regjistroi zhvlerësimin prej 30,000€ për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Vlera e drejtë e pasurisë më 31 dhjetor 2012 është 310,000€. Bilanci i Gjendjes (Pasqyra e Pozitës Financiare) e përgatitur më 31 dhjetor 2012, do të:

- A. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si emër të mirë (goodwill).
- B. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si pjesë e impianteve dhe pajisjeve.
- C. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si kapital vlerësues.
- D. Të mos raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra.

46. Nga këndvështrimi i investitorit, cila prej letrave të mëposhtme me vlerë ofron rrezikun më të vogël?

- A. Obligacionet e hipotekës (e garantuara).
- B. Obligacionet e varur.
- C. Obligacionet në të ardhurat.
- D. Obligacionet e pa garantuara.

47. Një kompani që rishikon çdo vit mundësitë e saj të investimit dhe zgjedh shpenzimet e duhura kapitale për vitin e ardhshëm, paraqitet me dy projekte, të quajtura projekti A dhe projekti B. Vlerësimet më të mira tregojnë se shpenzimi i investimit për projektin A është 30,000€ dhe për projektin B është 1 milion euro. Projektet konsiderohen të kenë rrezik të njëjtë. Projekti A pritet të gjenerojë hyrje të mjeteve monetare prej 40,000€ në fund të çdo viti për dy vjet. Projekti B pritet të gjenerojë hyrje në para prej 700,000€ në fund të vitit të parë dhe 500,000€ në fund të vitit të dytë. Kompania ka një kosto të kapitalit prej 8%.

Norma e brendshme e kthimit të projektit A, në pikën më të afërt të plotë, është:

- A. 10%.
- B. 15%.
- C. 25%.
- D. 100%.

48. Kur një qira plotëson disa kritere, ajo duhet të kapitalizohet për qëllime të raportimit financiar. Qiraja e kapitalizuar do të rezultojë në raportimin e zërave në pasqyrat financiare që ndryshojnë nga zërat që raportohen për një qira operative. Cila nga grupet në vijim përfaqëson zërat që do të raportohen nga një qiramarrës i pajisjeve nën qiran kapitale (marrja e pajisjeve me lizing)?

- A. Shpenzimet e qirasë dhe parapagimi i qirasë.
- B. Shpenzimet e interesit dhe parapagimi i qirasë.
- C. Shpenzimet e zhvlerësimit dhe shpenzimet e interesit
- D. Shpenzimet e zhvlerësimit dhe shpenzimet e qirasë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** Nga 2 pikë secila

49. Cila është kërkesa kryesore për menaxherët e kontekstit të ulët që bëjnë biznes në kulturat e kontekstit të lartë?

- A. Formaliteti.
- B. Fleksibiliteti.
- C. Durimi.
- D. Shpejtësia.

50. Lidhur me rregullimin e qeverisë:

- A. Rregullimi po rritet në të gjithë botën.
- B. Shumë organizata nuk duhet të përballen me rregullimin e qeverisë.
- C. Kompanitë e shërbimeve publike nuk përballen me shumë rregullore.
- D. Derregulimi dhe privatizimi po rriten në mbarë botën.

**Fletë për ushtrime - mos i paraqitni zgjidhjet këtu!**